# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5599
E enjte, 11 tetor 2018
çmimi 0.40 €


## Limaj, kryetarëve të degëve të Nismës: Përgatituni për fitoren e re!

FAQE 5





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAJ FAQE 4-5

# Rezoluta për dialogun përfshinë pikëpamjet e të gjitha partive

Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se draftrezoluta për dialogun me Serbinë që do të prezantohet sot (e enjte) në takimin me liderët e subjekteve politike i përfshinë interesat shtetërore në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka treguar se ky dokument përfshinë edhe pikëpamjet e të gjitha partive politike në vend. Ai i ka ftuar të gjitha subjektet politike që të reflektojnë karshi dialogut Kosovë - Serbi, duke shtuar se ky proces është përgjegjësi e të gjithëve

## Kosova lanson fushatën vetëdijesuese për liberalizimin e vizave

Institucionet e Kosovës të mërkurën kanë lansuar fushatën vetëdijesuese për procesin e liberalizimit të vizave e cila ka për synim dhënien e mesazheve se ky proces nuk duhet të keqpërdoret. Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, kanë bërë me dije se kjo fushatë ka për qëllim diskutimin me popullin për të drejtat dhe detyrimet që dalin nga regjimi i vizave FAQE 3




## Veseli: PDK-ja mbetet adresa më e mirë për shtet, integrim dhe zhvillim

FAQE 7




## AKTUALE

KOSOVA NGRIHET NË STATUS NË ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE TË FRANKOFONISË F. 2

BANKA BOTËRORE NUK E PËRKRAH TERMOCENTRALIN 'KOSOVA E RE' F. 2

GAP-i: PREJ 900 PREMTIMEVE, VETËM 95 JANË PËRMBUSHUR NGA KRYETARËT E KOMUNAVE F. 6

## EKONOMI

BRENDA KËTIJ VITI 18 RASTE TË VDEKJES NË VENDIN E PUNËS F. 9

STUDENTËT E KEDS ACADEMY, VIZITË PROFESIONALE NË TURQI F. 9

## KULTURË

SHTËPIA E LINDJES E ADEM DEMAÇIT, NË MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE F. 11



## SPORT

'DARDANËT' PËR FITORE NDAJ MALTËS F. 18

TEB-i MBËSHTET BASKET-BOLLIN DHE FUTBOLLIN F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kosova ngrihet në status në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë

**Prishtinë, 10 tetor** - Në sesionin ministror të 84 vendeve anëtare të kësaj organizate u konfirmua kërkesa e Kosovës për avancimin e statusit të Kosovës, nga anëtar vëzhgues në atë të asocuar, që është status i rangut të lartë. Lajmin e ka bërë me dije zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. "Ditën e enjte pritet vetëm konfirmimi", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".
Pacolli në fjalën e tij përpara ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të Organizatës së Frankofonisë ka shprehur përkushtimin dhe vullnetin e Republikës së Kosovës për ta avancuar statusin tonë në këtë organizatë të rëndësishme. "Jam optimist që në mbyllje të samitit Kosova do ta marrë statusin e anëtarit të asocuar dhe do ta vazhdojë faktorizimin e vet", ka shkruar ministri Pacolli. Ai ka bërë me dije se vendeve anëtare të Frankofonisë u ka kërkuar mbështetje dhe i ka falënderuar për konstruktivitetin e trajtimit të çështjes së Kosovës. "Kosova do ta marrë vendin e merituar për ta dhënë kontributin e vet në paqen dhe stabilitetin rajonal dhe botëror", është shprehur Pacolli.




# Banka Botërore nuk e përkrah termocentralin 'Kosova e Re'

Presidenti i Grupit të Bankës Botërore, Jim Yong Kim, ka bërë me dije se Banka Botërore nuk do ta mbështesë ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" në Kosovë. Kimi e ka bërë të qartë qëndrimin e Bankës Botërore rreth termocentralit 1.3 miliard euro kur u pyet nga Visar Azemi, drejtor ekzekutiv i "Balkan Green", në takimet vjetore të Grupit të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar që po zhvillohen në Bali të Indonezisë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 10 tetor** - Drejtori ekzekutiv i organizatës joqeveritare "Balkan Green Foundation", Visar Azemi dhe Burim Ejupi nga Instituti për Politikat Zhvillimore (INDEP), po marrin pjesë në takimet vjetore të Grupit të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar në Bali të Indonezisë. Këto takime bashkojnë bankierët qendrorë, ministrat e financave dhe të zhvillimit, drejtuesit e sektorit privat, shoqërinë civile, mediet dhe akademinë për të diskutuar çështje mbi perspektivën ekonomike botërore, stabilitetin financiar global, çrrënjosjen e varfërisë, rritjen ekonomike dhe ndryshimet klimatike.
Gjatë një takimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, drejtoresha menaxhuese e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Christine Lagarde dhe presidenti i Grupit të Bankës Botërore, Jim Yong Kim, diskutuan me shoqërinë civile një gamë të gjerë temash zhvillimore.
Ndër të tjera, gjatë takimit në fjalë Visar Azemi i drejtoi pyetje Kimit lidhur me qëndrimin e Bankës Botërore për mbështetjen e projektit me qymyr në Kosovë, ku Kimi konfirmoi se Banka Botërore ka marrë një vendim të qartë për të mos e përkrahur termocentralin "Kosova e Re". "Na kërkohet me aktet tona nënligjore t'i ndjekim opsionet me kosto më të ulët, meqë burimet alternative tani janë nën koston e qymyrit. Nuk do ta mbështesim një projekt të tillë", ka thënë Kim.




Tani "Balkan Green Foundation" i bën thirrje BERZh-it dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare që të deklarojnë nëse do të ndjekin të njëjtin veprim si Banka Botërore dhe ta mbështesin tranzicionin drejt shfrytëzimit të burimeve të ripërtërishme për prodhimin e energjisë, ndërkohë që largohen nga lëndët djegëse fosile.
Nënshkrimi i marrëveshjes 1.3 miliard euro mes Qeverisë së Kosovës dhe Joseph Brandt, drejtorit ekzekutiv të kompanisë amerikane "Countur Global" për ndërtimin e TC "Kosova e Re", është bërë më 20 dhjetor 2017. Në qershor të këtij viti kompania amerikane "Contour Global" ka hapur tender për ndërtimin e termocentralit të tretë në Kosovë të quajtur "Kosova e Re". Katër konsorciume tashmë kanë hyrë në garë për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re".
Është parashikuar që në vitin 2019 do të vihet gurthemeli i termocentralit "Kosova e Re".

## Presidenti: AFET e konsideron krejt të mundshëm opsionin e korrigjimit të kufirit

**Prishtinë, 10 tetor (ER)** - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mirëpritur të mërkurën miratimin e draftrezolutës për Kosovën nga Komiteti i Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian. "Komiteti i Punëve të Jashtme i Parlamentit Evropian (AFET) ka miratuar draftrezolutën për Kosovën dhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. E mirëpres këtë vendim dhe i falënderoj eurodeputetët për votimin e djeshëm në Komitetin e Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian (AFET) për përkrahjen për liberalizimin e menjëhershëm të vizave dhe arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare të paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".
Ai ka thënë se vendimi për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës jo vetëm se është i merituar, por është i vonuar padrejtësisht. "Lidhur me fazën përfundimtare të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e mirëpres faktin që AFET bën thirrje për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese, që do të përkrahet nga të gjitha palët, që do ta ruajë karakterin shumetnik të shteteve tona dhe nuk do të krijojë kufij përgjatë vijave etnike. Mbi të gjitha, AFET e konsideron krejt të mundshëm opsionin e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, si zgjidhje kompromisi për marrëveshjen përfundimtare", ka thënë Thaçi.
Sipas tij, kjo qasje dhe përmbajtja e kësaj draftrezolute të miratuar nga AFET, e cila pritet të votohet në seancën plenare të Parlamentit Evropian, është identike me qasjen dhe argumentet siç ka shkruar Thaçi: "Argumentet tona për marrëveshjen përfundimtare". "Draftrezoluta është dëshmi se eurodeputetët e kanë kuptuar qartë se cili është opsioni më i mundshëm dhe real i arritjes së marrëveshjes përfundimtare, e cila Kosovës ia siguron njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në BE, NATO dhe OKB. Shpresoj se miratimi i kësaj draftrezolute do t'u ndihmojë të gjithë në Kosovë, pra institucionet dhe partitë politike, që ta kuptojnë se cili opsion mund ta bëjë të mundur arritjen e marrëveshjes përfundimtare", ka deklaruar ai.



Sipas presidentit Thaçi, Parlamenti Evropian është institucioni i vetëm i BE-së që Kosovën e trajton shtet të pavarur dhe sovran. "Prandaj, votimi i djeshëm nga AFET është mbështetje e fuqishme për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare për ta tejkaluar status quon aktuale të rrezikshme, e cila ka tendenca të përkeqësimit, jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin", ka theksuar presidenti Thaçi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kosova lanson fushatën vetëdijësuese për liberalizimin e vizave

Institucionet e Kosovës të mërkurën kanë lansuar fushatën vetëdijësuese për procesin e liberalizimit të vizave e cila ka për synim dhënien e mesazheve se ky proces nuk duhet të keqpërdoret. Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, kanë bërë me dije se kjo fushatë ka për qëllim diskutimin me popullin për të drejtat dhe detyrimet që dalin nga regjimi i vizave. Fushata do të jetë gjithëpërfshirëse dhe përmes saj synohet të arrihet nivel i kënaqshëm i vetëdijesimit në mënyrë që të mos bëhet keqpërdorim apo të rrezikohet liberalizimi për shkak të mungesës së informacioneve




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 TETOR - Ministria e Integrimit Evropian (MIE) të mërkurën ka lansuar fushatën vetëdijesuese për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë ceremoni ka qenë e pranishme ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, kryeministri Ramush Haradinaj, shefja e Zyrës së BE-së, Nataliya Apostolova, si dhe ambasadori i Gjermanisë, Christian Heldt.
Me këtë rast ministrja Hoxha ka falënderuar GIZ-in, Ambasadën e Gjermanisë dhe Zyrën e BE-së për përkrahjen që i kanë dhënë liberalizimit të vizave, duke thënë se tani Kosova është një hap më afër këtij procesi dhe sfida e fundit, sipas saj, do të jetë votimi në Këshillin e Ministrave. "Ne nuk do ta ndalim punën me marrjen e rekomandimit pozitiv, reformat do të vazhdojnë me intensitet edhe më të shtuar. Sfida e radhës janë shtetet anëtare me të cilat jemi duke punuar shumë. Kemi ndërmarrë disa hapa në mënyrë që t'i adresojmë brengat eventuale të secilit shtet anëtar veç e veç", ka deklaruar Hoxha, duke cekur fuqizimin e legjislacionit për të huajt, sigurinë e kufijve, migracionin konform standardeve evropiane si dhe zbatimin e marrëveshjeve të riatdhesimit.
Ajo ka bërë me dije se lansimi i fazës së re të fushatës vetëdijesuese për qytetarët e Republikës së Kosovës ka për qëllim qasjen e qytetarëve me informatat e duhura se çka është liberalizimi i vizave. "Fushata ka për qëllim kryesor qasjen te qytetarët me informatat e duhura se çka është dhe çka nuk është liberalizimi i vizave, ku dhe sa mund të qëndrohet si dhe rregullat e tjera të Zonës Shengen", ka theksuar Hoxha. Ajo ka thënë se Qeveria e Kosovës do të mbështesë këtë fushatë me mjete shtesë krahas mbështetjes së GIZ-it. "Do të sigurohemi të gjithë së bashku që mesazhet që do të përçohen të jenë të duhurat dhe mjaftueshëm informuese për qytetarin. Do të shkojmë në çdo qytet, fshat e lagje në mënyrë që qytetarët tanë të jenë pjesë aktive e kësaj fushate. Përveç Qeverisë dhe dikastereve të saj, fushata do të zgjerohet dhe mbështetet edhe nga Kuvendi dhe institucionet e tjera", është shprehur Hoxha.
Ministrja ka thënë se kjo fushatë do të jetë gjithëpërfshirëse dhe së bashku me qytetarët synohet të arrihet nivel i kënaqshëm i vetëdijesimit në mënyrë që të mos bëhet keqpërdorim apo të rrezikohet liberalizimi për shkak të mungesës së informacioneve. "Do ta dëgjojmë zërin e qytetarëve dhe do të japim mesazhe të qarta se liberalizimi i vizave nuk guxon dhe nuk duhet të keqpërdoret. Më lejoni që sot ta shfrytëzoj rastin që t'i ftoj të gjithë qytetarët, institucionet, shoqërinë civile, mediet dhe misionet e shteteve anëtare në Kosovë, që të gjithë së bashku të jemi pjesë aktive e kësaj fushate, sepse vetëm me këtë bashkëveprim mund të jemi të suksesshëm", ka theksuar Hoxha.

## Haradinaj: Lëvizja e lirë është e drejtë dhe privilegj, por ka edhe obligime

Ndërsa kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka quajtur të mërkurën ditë të posaçme, duke thënë se kjo fushatë ka për qëllim t'u sqarojë qytetarëve të Kosovës se lëvizja e lirë Shengen është një e drejtë dhe privilegj, por i ka edhe disa obligime e përgjegjësi të cilat duhen ditur. "Jemi qytetarë të lirë dhe kjo na takon. Jemi Evropë, kemi qenë, jemi dhe do të jemi gjithë jetën dhe është privilegj, por ka edhe obligime që duhen zbatuar me përpikëri", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se edhe nëse jepet liberalizimi, ndonjë vend anëtar mund të propozojë edhe pezullim prandaj, siç ka thënë ai, kjo temë nuk duhet neglizhuar. "Liberalizimi i vizave nuk është punë e lehtë, edhe kur jepet, mund të sanksionohet pastaj", është shprehur ai.
Kryeministri ka falënderuar Ministrinë e Integrimeve dhe Zyrën e Bashkimit Evropian dhe të gjithë ata që kanë kontribuar për t'u plotësuar kriteret për liberalizimin e vizave. Ai ka uruar që qytetarët e Kosovës sa më shpejt të lëvizim lirshëm dhe t'i dëshmohet familjes evropiane që jemi qytetarë të dinjitetshëm. Ndërsa shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka theksuar se së bashku me kryeministrin Haradinaj dhe ministren Hoxha është për ta mbështetur fushatën ndërgjegjësuese për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ajo ka vlerësuar se fushata është një mjet i rëndësishëm për të komunikuar qartë me popullin e Kosovës rreth procesit, për të drejtat dhe detyrimet që dalin nga regjimi i vizave.

# Aktakuza për listat e veteranëve i kthehet Prokurorisë

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Gjykata Themelore në Prishtinë të mërkurën e ka kthyer në Prokurorinë Speciale aktakuzën për çështjen e fryrjes së listave të veteranëve të UÇK-së. Nëpërmjet një njoftimi për medie gjykata ka kërkuar përmirësime dhe qartësime nga Prokuroria Speciale.
Arsyeja e kthimit të aktakuzës, sipas kryetares së Trupit Gjykues, bie për shkak se dispozitivi i aktakuzës në pjesën e përshkrimit faktik të veprës penale është konfuz dhe, si i tillë, nuk lejon mundësimin e procedimit të drejtë pa zvarritje e pengesa të shumta të këtij procesi. "Gjykata Themelore në Prishtinë njofton se lidhur me aktakuzën e ngritur kundër të pandehurve A. Ç., N. L., S. H., Sh. D., Q. G., Sh. B., A. D., Rr. B., F. F., S. E., F. Sh. dhe Xh. J. për veprën penale nga neni 422, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, e pranuar në Gjykatë më 14. 9. 2018, pas vlerësimit të kryetares së Trupit Gjykues, e cila është ngarkuar me lëndën, është vendosur që aktakuza në fjalë t'i kthehet për përmirësim dhe qartësim Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për shkak se e njëjta nuk është përpiluar konfrom nenit 241, paragrafi 1, pika 1.4 të KPP-së. Po ashtu, janë dhënë edhe arsyet lidhur me anulimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e masës së përkohshme për sigurimin e kërkesës pasurore juridike", është theksuar në njoftimin e gjykatës.


AFP

Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

# Rezoluta për dialogun përfshinë

Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se draftrezoluta për dialogun me Serbinë që do të prezantohet sot (e enjte) në takimin me liderët e subjekteve politike i përfshinë interesat shtetërore në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka treguar se ky dokument përfshinë edhe pikëpamjet e të gjitha partive politike në vend. Ai i ka ftuar të gjitha subjektet politike që të reflektojnë karshi dialogut Kosovë - Serbi, duke shtuar se ky proces është përgjegjësi e të gjithëve



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 TETOR - Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka ftuar edhe një herë të gjitha subjektet politike që të reflektojnë në raport me dialogun Kosovë -Serbi. Ai ka bërë me dije se draftrezoluta për dialogun me Serbinë, e cila do të prezantohet sot (e enjte) në takimin me liderët e subjekteve politike, përfshinë interesat shtetërore të vendit dhe pikëpamjet e të gjitha partive politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka deklaruar se nëse ekziston vullneti politik i opozitës për konsensus, ai mund të arrihet. "Iniciativa e z. Veseli dhe PDK-së është një iniciativë e cila në mënyrën më të mirë të mundshme i përfshinë interesat shtetërore të vendit dhe pikëpamjet e të gjitha partive politike. Çdo gjë që është thënë për dialogun, çka do të duhej të ndodhë me dialogun, çka do të duhej të mos ndodhte me këtë proces, cilat janë qëllimet tona në dialog dhe cilat janë vijat e kuqe në dialog, i parasheh projektrezoluta, të cilën ne si partnerë të koalicionit e kemi propozuar. Nëse ka vullnet politik mund të këtë rrugë dhe modele të reja se si të arrihet konsensusi politik për këtë çështje", ka thënë Hoxhaj.

Ai pret që në takimin e së enjtes të marrin pjesë të gjitha subjektet politike që janë ftuar. "Nuk dua t'i komentoj deklaratat e subjekteve politike. Një gjë e di, se prej z. Veseli ka vendosmëri që të krijojë një konsensus politik, sepse dialogu nuk është vetëm përgjegjësi e jona që jemi në Qeveri, dialogu është përgjegjësi edhe e atyre që janë në opozitë. Ne presim të respektohet vullneti i qytetarëve të Kosovës, përndryshe qytetarët e Kosovës duhet ta bëjnë dallimin se kush është i interesuar ta përmbyllë këtë temë dhe kush është i interesuar ta vazhdojë politiken e status quos dhe të qëndrojë në vend", është shprehur Hoxhaj.

**"Epoka e re":** *Z. Hoxhaj, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka ftuar për këtë të enjte një takim me të gjitha subjektet politike, ku do të diskutohet rreth draftrezolutës për dialogun me Serbinë. Cili është qëllimi i kësaj draftrezolute?*

**Hoxhaj:** Takimi do të mbahet, sepse ka të bëjë me një urgjencë të madhe politike që të shkohet në mënyrë unike në procesin e dialogut me Serbinë. Iniciativa e z. Veseli dhe PDK-së është një iniciativë e cila në mënyrën më të mirë të mundshme i përfshinë interesat shtetërore të vendit dhe pikëpamjet e të gjitha partive politike. Çdo gjë që është thënë për dialogun, çka do të duhej të ndodhtë me dialogun, çka do të duhej të mos ndodhte me këtë proces, cilat janë qëllimet tona në dialog dhe cilat janë vijat e kuqe në dialog, i parasheh projektrezoluta, të cilën ne si partnerë të koalicionit e kemi propozuar. Nëse ka vullnet politik mund të këtë rrugë dhe modele të reja se si të arrihet konsensusi politik për këtë çështje. Ftesa e z. Veseli qëndron dhe ne presim që të vijnë të gjithë ata që janë ftuar në këtë takim.

**"Epoka e re":** *Jua ka konfirmuar ndonjëri prej subjekteve opozitare pjesëmarrjen në takim?*

**Hoxhaj:** Nuk jam marrë me këtë pjesë teknike se kush e ka konfirmuar ardhjen, sepse kjo është punë e administratës së Kuvendit të Kosovës apo e PDK-së. Mirëpo e di se në këto dy javët e fundit kemi pasur një debat të mirëfilltë politik se si ta reflektojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës, se si ta përmbyllim shtetndërtimin dhe si ta kompletojmë sovranitetin. Situata që kemi pasur në fillim të shtatorit nuk ka qenë dinjitoze as për neve si Qeveri e as për kolegët në opozitë, ku kemi qëndruar për ditë të tëra në seanca pa arritur asgjë. Prandaj, atë që nuk e kemi arritur në javën e parë të shtatorit, mund të arrihet në tetor. Shpresoj se ka racionalitet dhe rezon shtetëror të çdo subjekti politik.

**"Epoka e re":** *LDK-ja përmes një komunikate për media ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në këtë takim, derisa Lëvizja Vetëvendosje më herët e ka bërë të qartë se nuk do të jetë pjesë e këtij takimi.*

**Hoxhaj:** Nuk dua t'i komentoj deklaratat e subjekteve politike. Një gjë e di, se prej z. Veseli ka vendosmëri që të krijojë një konsensus politik, sepse dialogu nuk është vetëm përgjegjësi e jona që jemi në Qeveri. Dialogu është përgjegjësi edhe e atyre që janë në opozitë. Ne presim të respektohet vullneti i qytetarëve të Kosovës, përndryshe qytetarët e Kosovës duhet ta bëjnë dallimin se kush është i interesuar ta përmbyllë këtë temë dhe kush është i interesuar ta vazhdojë politikën e status quos dhe të qëndrojë në vend.

**"Epoka e re":** *Çfarë nëse opozita*

# pikëpamjet e të gjitha partive



*nuk merr pjesë në këtë takim?*
**Hoxhaj:** Nuk dua që ta përshkruaj situatën hipotetike. Ta presim ditën e enjte.

**"Epoka e re":** *Mirëpo dy subjektet më të mëdha opozitare e kanë bërë të qartë se nuk do të jenë pjesë e këtij takimi. Si do të veprohet me këtë rezolutë? Do ta dërgoni në Kuvend edhe pa opozitën?*
**Hoxhaj:** Kjo është çështje e partnerëve të koalicionit. Kur të ndodhë takimi, besoj aty do t'i japim mendimet tona se si t'i qasemi kësaj rezolute. Pa ndodhur takimi i liderëve, nuk dua të them se ky do të jetë epilogu.

**"Epoka e re":** *Në këtë mënyrë është tentuar disa herë të arrihet një konsensus kombëtar, por nuk është arritur. Çka ju shtyn të besoni se këtë herë do të arrihet konsensusi i kërkuar?*
**Hoxhaj:** Ne jemi vetëm një parti politike dhe në këtë mënyrë po e reflektojmë synimin tonë politik, vullnetin tonë politik dhe gatishmërinë tonë për të arritur një konsensus për ta mbyllur një temë, të cilën e kemi bartur si proces edhe me kolegët e tjerë që janë opozitë. Kohët e fundit e kemi pasur një debat se si dialogu të afatizohet, se si ky proces ta sjellë njohjen e ndërsjellë me Serbinë dhe si Kosova ta kompletojë sovranitetin e vet, dhe për këtë mendoj se koha është tani, ngaqë kjo situatë politike ku ne nuk tregohemi unikë, ku reflektojnë dallimet tona, mund t'i shkojnë përshtati vetëm Serbisë. Në këtë situatë ajo mund ta drejtojë gishtin kah ne, që nuk po pajtohemi mes vete dhe në këtë mënyrë BE-ja nuk do të jetë në gjendje që deri në pafundësi ta presë elitën politike të Kosovës se kur ne mund të merremi vesh për formatin e dialogut. Mendoj se përballja më interesante nuk është në Prishtinë, nëpër debate televizive e as në konferenca për media. Përballja kryesore është në Bruksel, aty duhet të përballemi me Serbinë, ndërsa në Nju Jork duhet të përballemi me kundërshtarët strategjikë të pavarësisë së Kosovës.

**"Epoka e re":** *Derisa ju po kërkoni konsensus, opozita po kërkon zgjedhje të reja.*
**Hoxhaj:** Çfarëdo që keni të pyesni për opozitën, mund ta pyesni atë. Unë këtu po i jep qëndrimet e mia.

**"Epoka e re":** *Zgjedhjet e reja janë parë si alternativë, sidomos pas polemikës së fundit në mes presidentit dhe kryeministrit të vendit rreth çështjes së kufirit?*
**Hoxhaj:** Presidenti e ka mandatin e vet në bazë kushtetuese dhe ai flet në emër të Kosovës për temat e karakteri kombëtar. Kurse ne çka jemi në Qeveri, si partnerë të koalicionit, flasim në emër të partive politike. Se kush çfarë thotë në konferenca për media është qëndrim i tyre. Qëndrimi ynë si PDK është i qartë, duam që t'i përmbushim disa prej qëllimeve të mëdha. E dini që herën e fundit patëm shkuar në zgjedhje për ta sjellë një Qeveri të vendimeve të mëdha. Dy vendime të mëdha deri më tani i kemi kryer: ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe vendimin për transformimin e FSK-së në ushtri. Dhe tani mendoj se duhet të vazhdohet qasja e njëjtë. Nuk mundet një vend si Kosova, në një periudhë të brishtë të shtetndërtimit të saj, ta ketë luksin e organizimit të zgjedhjeve çdo vit.

**"Epoka e re":** *Pra, përplasjet e fundit në mes të presidentit dhe kryeministrit nuk do të mund të ndikojnë në jetëgjatësinë e kësaj Qeverie?*
**Hoxhaj:** Mendoj se çfarëdo që doni ta pyesni presidentin, mund t'i drejtoheni zyrës së tij. Unë po flas për qëndrim të PDK-së dhe nuk jam këtu për të bërë analiza politike se kush e çfarë deklaron.

**"Epoka e re":** *Tani Kosova është edhe para sfidës së anëtarësimit në Interpol. Si qëndrojnë punët me vota?*
**Hoxhaj:** Mendoj se është jetike për Kosovën të anëtarësohet në Interpol. Nuk e di se cili është trendi i fundit dhe si qëndrojmë me vota. Por, e di se ka një koordinim brendapërbrenda Qeverisë për këtë çështje. Anëtarësimi i Kosovës në Interpol do të ishte lajmi më i mirë për Kosovën në vitin 2018. Ndërsa, nëse Serbia sillet në raport me Kosovën në Interpol sikurse është sjell në UNESCO, ne do të duhej të nxjerrim një bilanc të mirëfilltë se si të sillemi në raport me Serbinë. Ne nuk mund t'i normalizojmë raportet bilaterale me Serbinë derisa ajo ndërkombëtarisht na lufton kudo.

# Limaj, kryetarëve të degëve të Nismës: Përgatituni për fitoren e re

**GJAKOVË, 10 TETOR (ER)** - Në takimin me strukturat e Nismës Socialdemokrate të Dukagjinit që është mbajtur të mërkurën në Gjakovë, kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka folur për ecjen e kësaj partie dhe angazhimin e saj në këtë Qeveri. Limaj ka thënë se në të gjitha ministritë ka probleme por, sipas tij, po angazhohen që ato të zgjidhen. Ai ka thënë se për këta muaj janë arritur rezultate të mëdha por, pavarësisht prej kësaj, Limaj ka bërë thirrje për angazhim të shtuar.

Ai ka kërkuar angazhim të kryetarëve të degëve të Nismës Socialdemokrate në rajonin e Dukagjinit në çdo temë për shtetin dhe komunën ku veprojnë. "Vetëm kështu mund të rritet partia. Përgatituni për betejën e re, për fitoren e re", ka thënë Limaj. Ai ka lavdëruar punën dhe angazhimin që po bën kryetari i Degës së Nismës në Gjakovë, Fazli Hoxha. Ky i fundit ka thënë se ky subjekt politik po dëshmohet se është parti e kthimit të shpresës për qytetarët e Gjakovës dhe mbarë Kosovës. Hoxha ka thënë se Nisma Socialdemokrate po fuqizohet në Gjakovë dhe në të gjitha komunat e tjera. Ai ka treguar se Dega e Nismës Socialdemokrate në Gjakovë është në bashkëqeverisje me disa parti dhe është e përfaqësuar në Asamblenë Komunale me tre këshilltarë. "Me miratimin e buxhetit për vitet 2019 - 2021 janë të përfshira shumë projekte të Nismës Socialdemokrate që ne i kemi prezantuar gjatë fushatës zgjedhore. Realizimi i këtyre projekteve po reflekton drejtpërdrejt në zgjidhjen e shumë problemeve të qytetarëve të Gjakovës", ka thënë Hoxha. Ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate, e prirë nga Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi, po dëshmohet se është parti që kërkon përgjegjësi për marrjen e vendimeve të mëdha, "vendime këto që po ndryshojnë për të mirë gjendjen e qytetarëve të Kosovës. Pra, Nisma Socialdemokrate përmes vendimeve të veta në Qeveri dhe Parlament po kujdeset që Kosova ta ketë një perspektivë më të mirë në ecjen e saj si shtet", është shprehur Hoxha.

Fazli Hoxha, i cili është edhe anëtar i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, ka folur edhe për formimin e ushtrisë së Kosovës dhe për procesin e liberalizimit të vizave.



## Dënohen të akuzuarit në rastin e vrasjes së Aulon Zekës

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin ndaj të miturit G. H., për veprën penale "Vrasje e rëndë" dhe veprës tjetër "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".
Fjala është për të akuzuarit në rastin e vrasjes së të riut, Aulon Zeka, vitin e kaluar në Prishtinë. "I mituri G. H. është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej nëntë vjet e gjashtë muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt. 17. 9. 2017 e tutje", është thënë në njoftimin e gjykatës.
Gjykata ka shpallur aktgjykimin edhe për dy personat e tjerë që kanë ndihmuar kryesin e veprës penale pas aktit të vrasjes. Të miturës R. G. i është shqiptuar masa edukativo-korrektuese në kohëzgjatje prej tri vjetësh. Kurse të miturit L. Ll i është shqiptuar mbikëqyrje e shtuar nga organi i kujdestarisë në kohëzgjatje prej një viti e gjashtë muaj.



# GAP-i: Prej 900 premtimeve, vetëm 95 janë përmbushur nga kryetarët e komunave



Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 TETOR - Instituti GAP ka publikuar në platformën online dinamikën e realizimit të premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët aktualë të komunave në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në tetor dhe nëntor të vitit 2017. Prej 900 premtimeve të dhëna në 26 komuna, për pjesën e parë të këtij mandati janë përmbushur plotësisht 95 premtime, pjesërisht të përmbushura rezultojnë 53 premtime, ndërsa në 301 premtime ka pasur nisma për përmbushjen e tyre, përderisa 455 premtime ende nuk kanë nisur së realizuari.
Numri më i madh i premtimeve të realizuara është shënuar në fushën e infrastrukturës, arsimit dhe administratës. Ndërsa fushat ku ka më së paku lëvizje për përmbushjen e premtimeve është ajo e ekonomisë, shëndetësisë, bujqësisë, shërbimeve publike si dhe në fushën e urbanizimit.
Disa nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë zgjedhore, gjë që e bën vlerësimin e premtimeve të pamundur. Komunat si Skenderaj, Mamushë dhe dhjetë komunat e banuara me popullatë shumicë serbe nuk kanë shpalosur ndonjë program zgjedhor dhe nuk kanë dhënë premtime konkrete.
Instituti GAP vlerëson faktin se kandidatët për kryetarë të komunave gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2017 kanë qenë më të kujdesshëm për dhënien e premtimeve, zgjidhja e të cilave është kompetencë e niveleve të tjera të qeverisjes.
Përmes vlerësimit të premtimeve zgjedhore, Instituti GAP ka për qëllim t'i mbajë të përgjegjshëm kryetarët e zgjedhur për premtimet e dhëna dhe ta ruajë besimin e qytetarëve rreth procesit zgjedhor. Në vazhdimësi, kjo bëhet edhe në bashkëpunim me organizatat lokale të cilat duhet të fuqizohen edhe më tej për monitorimin e qeverisjes lokale.

## LGBT mbajti Paradën e Krenarisë në Prishtinë

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Me moton "Në emër të lirisë", pjesëtarët e komunitetit LGBT (homoseksual, lesbike, biseksual dhe transgjinor) kanë mbajtur të mërkurën Paradën e Krenarisë në Prishtinë. Kjo është hera e dytë që ky komunitet ka mbajtur një paradë të tillë.
Masa u tubua në Sheshin "Skënderbeu" dhe më pas ka vazhduar drejt Sheshit "Zahir Pajaziti". Pas marshit nëpër qendrën e Prishtinës, përfaqësuesi i komunitetit LGBT, Lend Mustafa, ka thënë se janë bashkuar për ta kërkuar lirinë. "Sot në emër të lirisë i ftojmë institucionet shtetërore që të mos na e mohojnë identitetin, të ofrojnë mundësi të barabarta dhe t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre për të drejtat e njeriut dhe të shkojmë drejt një shoqërie diverse", ka thënë para masës së mbledhur, Lend Mustafa. Ai ka falënderuar edhe aktivistët e LGBT-së nga rajoni që ndihmuan në këtë organizim. Po ashtu, një falënderim të veçantë kishte edhe për Policinë e Kosovës, duke thënë se ishte tërë kohën në vendin e duhur për mbrojtjen e pjesëtarëve të LGBT-së.
Krahas organizatorëve nga ky komunitet, në paradë morën pjesë edhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian, Natalyia Apostolova, kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe personalitete nga shoqëria civile. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ofruar mbështetje institucionale për organizimin e kësaj parade.






Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur Konventën për hapjen e zgjedhjeve të brendshme

# Veseli: PDK-ja mbetet adresa më e mirë për shtet, integrim dhe zhvillim

**Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se nga procesi i brendshëm zgjedhor do të varet e ardhmja e PDK-së dhe e shtetit. Sipas tij, këto zgjedhje do ta nxjerrin PDK-në edhe më të fortë. Veseli ka kërkuar nga strukturat partiake proces demokratik dhe transparent. Ai ka thënë se askush nuk duhet të lihet anash dhe të përjashtohet**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 TETOR - Me rastin e 19-vjetorit të themelimit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) të mërkurën është bërë hapja e zgjedhjeve të brendshme në këtë subjekt politik. Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se rrugëtimi 19-vjeçar i kësaj partie nuk ka qenë i lehtë. Ai ka theksuar se gjatë kësaj periudhe janë bërë gabime dhe lëshime të cilat e kanë dëmtuar PDK-në. "Nuk do të ndalemi sepse, kur ndalet PDK-ja, ndalet Kosova. Prandaj kurrë nuk do të ndalemi. Kemi veç një jetë, një atdhe dhe një qëllim: Kosovën. Rrugëtimi ynë 19-vjeçar nuk ka qenë i lehtë. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë gabime dhe lëshime të cilat na kanë dëmtuar. Ka ardhur koha ta fuqizojmë Kosovën dhe vetveten", është shprehur Veseli. Ai ka theksuar se nga PDK-ja pritet më shumë punë dhe në këtë kontekst, Veseli ka kërkuar nga ministrat dhe kryetarët e komunave rezultate konkrete dhe jo fjalë. "Armiku i Kosovës nuk është nga jashtë, është korrupsioni dhe ne do ta luftojmë atë. Nga ne presim që të punojmë më shumë dhe më mirë. Kam kërkuar nga ministrat dhe kryetarët e komunave rezultate, jo fjalë", është shprehur ai.

Veseli ka vlerësuar se "Dekada e Re" do të jetë një rrugë e gjatë dhe e pandalshme. Sipas tij, kjo do të jetë dekada e shëndetësisë dhe e inovacionit. "Dekada e re është dekadë e shëndetësisë. Kemi filluar transformimin e shëndetësisë dhe do ta përmbyllim këtë projekt madhor për Kosovën. 'Dekada e re' është dekadë e inovacionit. Nga ekonomia konsumuese, do të kalojmë në ekonomi prodhuese. Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm, por na duhen idetë e guximshme ekonomike", ka theksuar Veseli, duke shtuar se Kosova duhet ta vazhdojë dialogun me Serbinë e bashkuar në mënyrë që ta përfitojë njohjen reciproke, anëtarësimin në OKB si dhe përshpejtimin e anëtarësimit në NATO dhe BE. "Duhet të jemi të bashkuar për të dialoguar me Serbinë", ka deklaruar ai.



Duke folur për zgjedhjet brenda PDK-së, ai ka thënë se ky proces duhet të jetë demokratik dhe transparent. Sipas tij, askush nuk duhet të anashkalohet dhe të përjashtohet. Veseli ka bërë me dije se pas përfundimit të procesit zgjedhor PDK-ja do të dalë edhe më e fortë. "Nga sot po hyjmë në zgjedhje demokratike. PDK-ja mbetet adresa më e mirë për shtet, integrim dhe zhvillim. Nga ky proces do të varet e ardhmja e PDK-së dhe do të varet se kush do të vendosë për të ardhmen e shtetit. Këto zgjedhje do ta nxjerrin PDK-në edhe më të fortë. Na duhet një proces demokratik dhe transparent. Askush nuk duhet të lihet anash dhe të përjashtohet. Secili është i nevojshëm", ka thënë Veseli.

Gjatë adresimit të tij para strukturave të PDK-së, Veseli ka folur edhe për ish-pjesëtarët e UÇK-së të cilët po gjykohen padrejtësisht, duke përmendur këtu ish-komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimin si dhe Fadil Demakun.

Ndërkaq nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hajredin Kuçi, në Konventën e kësaj partie, në hapjen zyrtare të procesit të zgjedhjeve të brendshme, ka falënderuar qytetarët që fuqizuan këtë subjekt politik. Kuçi ka thënë se PDK-ja është lokomotiva e proceseve politike në vend. Ai ka thënë se nga kjo konventë zyrtarisht nis edhe procesi i brendshëm në parti. Kuçi ka bërë thirrje për unifikim, duke ftuar edhe ata që më herët janë larguar nga PDK-ja, të kthehen sërish. Ai ka thënë se të bashkuar mund ta fuqizojnë shtetin. Kuçi u ka thënë të rinjve se PDK-ja është një shtëpi e ngrohtë për ta. "Gara për kryetar të PDK-së është për kryeministër të Kosovës. Këtu mendja na shkon te kryetrari Veseli", është shprehur ai. Ai ka thënë se PDK-ja ka nevojë për mbështetje. "PDK-ja ka nevojë të fuqizohet edhe më tutje. Edhe Republika ka nevojë për një PDK të fuqishme. Në fund të këtij procesi fituese do të jetë PDK-ja, Republika e Kosovës dhe qytetari", është shprehur Kuçi.

## LDK-ja thërret partitë e tjera për caktimin e datës për zgjedhjet e reja

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) përmes një komunikate për media ka bërë me dije se disa herë i ka bërë të qarta para opinionit dhe anëtarësisë së saj qëndrimet për dialogun me Serbinë. "Këto qëndrime duhet të jenë të qarta edhe për kryetarin e Kuvendit. Si parti politike, më e madhja në Kosovë, qëndrimet tona i shpalosim para anëtarësisë dhe qytetarëve tanë, kurse në Kuvend përmes grupit tonë parlamentar. LDK-ja është e gatshme të takohet me të gjitha partitë parlamentare për t'u marrë vesh për datën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe orientimet për dialogun pas këtyre zgjedhjeve", është theksuar në komunikatën e LDK-së.



# OAK dhe OEMVP shohin shumë mundësi për bashkëpunim

**Prishtinë, 10 tetor (ER)** - Njohja reciproke dhe shqyrtimi i mundësive të bashkëpunimit mes të dy odave në mënyrë që të kontribuojmë në zhvillimin e biznesit ishte qëllimi i takimit në mes të përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) dhe përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore (OEMVP).

Gjatë këtij takimi kryetari i bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka shpalosur misionin dhe aktivitetet që Oda e Afarizmit është duke ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të klimës së të bërit biznes në Kosovë. Gjithashtu, Krasniqi ka theksuar se OAK-u ka identifikuar probleme të shumta të të bërit biznes, andaj u shpreh se është i rëndësishëm bashkëpunimi me një odë me përvojë siç është OEMVP me qëllim të aplikimit të praktikave më të mira.





# Studentët e KEDS Academy, vizitë profesionale në Turqi

**Prishtinë, 10 tetor (ER)** - Dhjetë studentë të gjeneratës së pestë të KEDS Academy kanë qëndruar në Turqi fundjavën e kaluar. Përgjatë tri ditëve studentët e këtij programi mësimor kanë zhvilluar vizita në kompanitë "Limak" dhe "Çalik", si dhe kanë mbajtur trajnime që atyre do t'u shërbejnë për ngritje profesionale.

Vizitën e parë gjatë qëndrimit në Turqi studentët e zhvilluan në kompaninë "Limak Energy". Ata kanë parë nga afër se si zhvillohet puna në këtë kompani dhe thelluan njohuritë e tyre rreth menaxhimit të Departamentit të Tregtimit të Energjisë Elektrike. KEDS Academy është program mësimor që organizohet nga KEDS-i dhe ka për qëllim t'i përkrahë studentët vendorë të universiteteve publike të Kosovës në zhvillim të mëtutjeshëm akademik dhe profesional.

Akademia ofron programe të akredituara për studentë të institucioneve të arsimit të lartë dhe programe të tjera interaktive për studentë të shkollave të mesme teknike në Kosovë, me qëllim të zvogëlimit të numrit të papunësisë, duke ofruar mundësi punësimi në KEDS dhe njohuri për punësim në ndërmarrje të tjera të ngjashme.

Zëvendësdrejtori gjeneral i "Limak Energy", Mesut Serhat Dinc, i cili është edhe anëtar i Bordit Ekzekutiv në KEDS, njëherësh edhe ideator i KEDS Academy, e ka lavdëruar punën që po bëhet në këtë program mësimor. "Edhe ky vit ka qenë i suksesshëm. Është një udhëtim që po e shijojmë të gjithë. Unë shoh studentët, gjeneratën e re, që është shumë e kënaqur me këtë projekt. Kjo është shtysë për neve që ta vazhdojmë projektin edhe më tutje. I falënderoj mentorët dhe stafin e KEDS-it për punën. Edhe kjo gjeneratë e KEDS Academy është e mirë dhe pres që edhe në të ardhmen të punoj me ta në aspektin profesional. Ky udhëtim nuk përfundon, është vetëm fillimi. Do të vazhdoj më tutje në zyrat e KEDS-it", ka deklaruar Dinc.

## Dogana konfiskon lojëra të fatit të palicencuara

Prishtinë, 10 tetor (ER) - Në kuadër të parandalimit të veprimtarive ilegale, njësitë e Doganës kanë organizuar një aksion tek një lokacion i dyshuar për poker ilegal dhe lojëra fati ilegale. "Njësitë e Doganës kanë ushtruar kontroll të befasishëm në një lokal pa mbishkrim në Prishtinë. Gjatë kontrollit janë vërejtur se brenda lokalit ushtrohet veprimtari me lojëra të fatit të palicencuara. Gjatë kontrollit brenda lokalit janë gjetur edhe persona që ishin duke luajtur. Pronari i lokalit është larguar dhe nuk është paraqitur. Gjithashtu, në këtë lokal është kapur edhe tavolina e pokerit ilegal e cila ishte në përdorim", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës. Po në këtë lokal janë konfiskuar: Katër aparate për lojëra të fatit pa numër serik, një rulet pa numër serik, një Tavolinë pokeri dhe katër pjesë aparate. "Vlera e mallit konsiderohet të jetë rreth 16 500.00 euro. Rasti ka vazhduar për hetime të mëtejme. Dogana do të vazhdojë aktivitetet e tjera në kuadër të zbatimit të ligjit, por edhe kërkojmë ndihmën e qytetarëve që të ndihmojnë për identifikimin e lokacioneve", është bërë me dije në njoftimin e Doganës.



Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të hartojë strategji për t'i adresuar problemet e shëndetit dhe sigurisë në punë

# Brenda këtij viti 18 raste të vdekjes në vendin e punës




Për nëntë muaj të këtij viti kanë ndodhur 18 raste me fatalitet në vendin e punës. Kështu u bë me dije të mërkurën në tryezën e organizuar nga Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë dhe Qendrës për Avokim të Politikave "Gjendja e shëndetit dhe sigurisë në punë"

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 TETOR - Zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Çerkin Dukolli, mori pjesë në tryezën e organizuar nga Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë dhe Qendrës për Avokim të Politikave "Gjendja e shëndetit dhe sigurisë në punë". Me këtë rast zëvendësministri Dukolli, i cili është edhe kryesues i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, ka thënë se shëndeti dhe siguria në punë është prioritet institucional, i cili, para se të jetë obligim ligjor, në kuptimin e punësimit dhe çështjeve sociale, është çështje humane ngaqë kemi të bëjmë me ruajtjen e shëndetit dhe jetës së njeriut. Ai ka nënvizuar se aksidentet në punë, të cilat janë evidentuar dhe janë duke ndodhur në vendpunishtet e Republikës së Kosovës, qofshin ato me lëndime apo me fatalitet, janë shqetësuese për neve si shoqëri dhe në këtë kuptim po angazhohemi që të kemi adresime konkrete nga të gjithë mekanizmat relevantë për të parandaluar këtë situatë.

Dukolli ka shtuar se institucionet e Kosovës po ndërmarrin hapa ambiciozë në këtë fushë jo vetëm duke harmonizuar legjislacionin me BE-në, por edhe duke ndërtuar trupa inspektuese. "Përtej saj çdo vit po ndërmarrim fushata vetëdijësuese me qëllim që t'i informojmë palët për detyrimet që kanë në raport me aktet juridike të sigurisë dhe shëndetit në punë. Në këtë kuptim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar edhe Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili në kompetenca të veta ka propozimet, rekomandimet dhe hartimin e politikave për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përcjelljen në vazhdimësi të gjendjes së sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve", ka thënë ai.

Për të kontribuuar dhe rritur edhe më tutje sigurinë dhe shëndetin në punë, Këshilli ka marrë angazhime serioze, duke hartuar dhe miratuar planin e punës të veprimit dyvjeçar të Këshillit 2018-2019, duke parapare objektiva dhe aktivitete të caktuara në funksion të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë. "Gjatë vizitave të realizuara në terren, qoftë në kompani publike apo private, Këshilli ka dhënë vërejtjet e veta dhe u ka bërë thirrje punëdhënësve të ofrojnë kushte të sigurta pune e gjithsesi ka inkurajuar Inspektoratin e Punës që të mbikëqyrë në plotësi implementimin e ligjeve në fuqi", është shprehur zëvendësministri Dukolli.

Në kuadër të masave preventive KNSShP-ja është duke shqyrtuar çështjen e sëmundjeve profesionale që mund të fitohen si pasojë e vendit të punës dhe në këtë kuptim i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që ta hartojë regjistrin e këtyre sëmundjeve. "Po ashtu, kemi inkurajuar dy institutet e mjekësisë së punës në Gjakovë dhe Obiliq, që t'i realizojnë me profesionalizëm të gjitha vizitat sistematike të punëtorëve dhe ekzaminimet e nevojshme që kërkohen", ka deklaruar Dukolli.

Në këtë tryezë u raportua se për këta nëntë muaj të këtij viti kemi 18 raste me fatalitet. Prej këtyre, dy vdekje natyrore dhe 78 lëndime. "Kjo situatë nuk është aspak e mirë dhe kërkon adresime konkrete. Të dhënat që kemi, nga vizitat që kemi realizuar në terren dhe shqyrtimet e bëra rreth kësaj teme, ne po shkojmë drejt identifikimit të sektorëve që paraqesin rrezikshmërinë më të lartë, në këtë rast ndërtimtaria, si punëdhënësja më e madhe në vend, mbetet sektori më i rrezikuar, sigurisht edhe për specifikat e këtij sektori, pasuar nga energjetika, sektori i shërbimeve, i prodhimit", ka potencuar Dukolli.

Në cilësinë e kryesuesit të Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, Dukolli ka apeluar të gjithë punëdhënësve të krijojnë ambiente të sigurta pune për punëtorët, që të kujdesen për sigurinë e tyre dhe të tjerëve dhe t'i përdorin pajisjet e duhura për siguri dhe mbrojtje në punët e tyre specifike. Në këtë tryezë morën pjesë organizatat sindikale vendore, BSPK-ja, SBAShK-u, OEK-u, si dhe pjesëtarë të shoqërisë civile që trajtojnë çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë nga Kosova, Shqipëria dhe Serbia.


Armand Nimani (AFP)

# Filloi asfaltimi i rrugës nëntëkilometërshe në Mirash

Ferizaj, 10 tetor (ER) - Të mërkurën ka nisur asfaltimi i rrugës rreth nëntë kilometra në fshatin Mirash, me gjerësi gjashtë metra. Për t'i uruar banorët e zonës për këtë projekt si dhe për ta parë zhvillimin e punës aty doli i pari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, si dhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe atë të Bujqësisë, Burim Bajrami dhe Afrim Llabjani.

Kryetari Aliu e ka vlerësuar tejet të nevojshëm këtë investim që po realizohet nga qeverisja lokale për faktin se rruga që lidhte lagjet e ndryshme të këtij fshati dhe rruga kryesore ishin në gjendje katastrofale dhe të rrezikshme për kalimtarët.

Ndërkaq drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, ka thënë se ky projekt përfundimisht do t'u japë fund vuajtjeve të qytetarëve që frekuentojnë këtë rrugë. Ky projekt infrastrukturor është financim i Komunës së Ferizajt dhe Ministrisë së Infrastrukturës, me kosto prej 1.2 milion eurosh, që përfshinë asfaltimin e rrugës në gjatësi rreth nëntë kilometra, gjerësi gjashtë kilometra dhe ndërtimin e trotuareve në këtë gjatësi.





# Komuna e Prizrenit rrit kapacitetet e ujit për ujitje të kulturave bujqësore

Prizren, 10 tetor (ER) - Në kuadër të projektit për hapjen e puseve për ujitjen e tokave bujqësore, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me nënkryetarin Eshref Memaj dhe drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Egzon Elshani, përcollën nga afër punimet që po zhvillohen te fermerët përfitues.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 38,637.00 euro, ndërsa përfitues janë 45 fermerë,të cilët kanë aplikuar dhe i kanë plotësuar të gjitha kriteret për hapjen e këtyre puseve.

Komuna e Prizrenit në këtë projekt ka participuar me 75 për qind të shumës totale, ndërsa pjesa tjetër i ka takuar përfituesit. Ky projekt është realizuar nga Drejtoria e Bujqësisë me qëllim të krijimit të kushteve të nevojshme për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore.



# LShK-ja të premten mban takim letrar me nxënës krijues

Prishtinë, 10 tetor (ER) - Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës (LShK-ja) të premten në orën 12:15 organizon një takim letrar me nxënësit e Shkollës Fillore "Afrim Gashi" të Hajvalisë, Komuna e Prishtinës. Pos anëtarëve të LShK-së, punimet e tyre do t'i lexojnë edhe nxënësit e kësaj shkolle kurse, përveç pikave muzikore, do të zhvillohet edhe një bisedë rreth krijimtarisë letrare.

# Kërkohet hapja e një zyre komunale për konsumatorët në Mitrovicë



**Mitrovicë, 10 tetor (ER)** - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur të mërkurën në një takim pune kryetarin e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Sherif Zejnullahu, dhe kryetarin e OJQ-së "Konsumatori", Selatin Kaçanikun, me të cilët ka biseduar për punën e këshillit dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre.

Kryetari Zejnullahu fillimisht prezantoi punët të cilat ata i kryejnë nëpërmes këtij këshilli si dhe paraqiti edhe idenë e hapjes së një zyre komunale për konsumatorët, me qëllim që ata të mund t'i marrin këshillat e nevojshme, apo edhe të mund t'i paraqesin rastet e shkeljes së të drejtës së konsumatorit.

Nënkryetari Mujka e vlerësoi punën dhe rolin e këshillit për mbrojtjen e konsumatorit dhe shprehi gatishmërinë e Komunës së Mitrovicës për bashkëpunim me ta, me qëllimin e vetëm, që konsumatori të jetë i mbrojtur gjatë konsumit të përditshëm. "Ne si komunë do të mundohemi të gjejmë ndonjë zyrtar në komunën tonë që ta kryejë këtë detyrë sepse konsumatori është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë një person që të merret me edukimin dhe kujdesin ndaj tij", ka thënë nënkryetari Mujka.

## Të shtunën në Pejë mbahet akademi letrare për prof. dr. Muhamed Kërveshin



PEJË, 10 TETOR (ER) - Të shtunën, në orën 12:00, Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës dhe Qendra Kulturore e Pejës organizojnë akademi letrare për poetin, kritikun, shkencëtarin dhe pedagogun, prof. dr. Muhamed Kërveshi, në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës. Për prof. Kërveshin dhe veprimtarinë e tij letrare, shkencore dhe pedagogjike do të flasin kolegë e studiues kurse, pos deklamimeve të vargjeve të tij, do të ketë edhe pika muzikore-artistike. Shkrimtari, studiuesi dhe pedagogu Kërveshi është ndër emrat më të shquar të letërsisë shqiptare. Akademia mbahet në përkujdesje të kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri.

Rreth 1 595 asete vihen nën mbrojtjen e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore

# Shtëpia e lindjes e Adem Demaçit, në mbrojtje të trashëgimisë kulturore



Disa prej aseteve të cilat janë përfshirë këtë vit si propozime të reja në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme janë: Shtëpia e lindjes e Adem Demaçit; Shtëpia e Adem Demaçit; Qendra Tregtare Gërmia - Prishtinë; Selia e Shtabit të Brigadës 121 Komandant "Kumanova"; Kompleksi Përkujtimor "Mujë Krasniqi"; Shtëpia Muze e Fadil Vatës, Shtëpia e Kulturës në Runik dhe disa objekte të tjera të cilat tashmë gëzojnë status të ndërtesave, aseteve të mbrojtura sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 TETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, të mërkurën ka nënshkruar vendimin për aprovimin e listës së trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme me 1 595 asete, të cilat do t'u nënshtrohen masave dhe regjimit mbrojtës sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore. Këtë vit, janë propozuar, shqyrtuar dhe aprovuar edhe mjaft propozime të reja të objekteve të cilat bartin në vete ngjarje, çaste e periudha të rëndësishme nga historia, kujtesa kolektive e zhvillimit urban, social, tregtar dhe infrastrukturor të vendit të gjitha këto dhe jo vetëm, vlera të pakontestueshme që duhen ruajtur, mbrojtur dhe promovuar.

Disa prej aseteve të cilat janë përfshirë këtë vit si propozime të reja në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme janë: Shtëpia e lindjes e Adem Demaçit; Shtëpia e Adem Demaçit; Qendra Tregtare Gërmia - Prishtinë; Selia e Shtabit të Brigadës 121 Komandant "Kumanova"; Kompleksi Përkujtimor "Mujë Krasniqi"; Shtëpia Muze e Fadil Vatës, Shtëpia e Kulturës në Runik dhe disa objekte të tjera të cilat tashmë gëzojnë status të ndërtesave, aseteve të mbrojtura sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore. Ministrit i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) Kujtim Gashi, ka bërë me dije se MKRS-ja dhe institucionet e trashëgimisë kulturore do të jenë maksimalisht të angazhuara në të gjitha fazat e realizimit të plotë të mandatit të tyre për t'i zbatuar masat, obligimet dhe standardet profesionale të ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave tona të trashëgimisë kulturore. "Dua t'i falënderoj të gjitha palët e angazhuara, në çfarëdo forme, në debatin dhe procedurat e tjera të aprovimit të listës, si zërat e opinionit publik, ekspertët e jashtëm, personat fizikë të përfshirë në cilësi të ndryshme, institucionet lokale dhe institucionet, profesionistët dhe komisionet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për përmbylljen me sukses të këtij procesi", ka thënë ministri Kujtim Gashi, pas nënshkrimit të listës.

Ai ka falënderuar të gjitha palët e angazhuara, në çfarëdo forme, në debatin dhe procedurat e tjera të aprovimit të listës, si zërat e opinionit publik, ekspertët e jashtëm, personat fizikë të përfshirë në cilësi të ndryshme, institucionet lokale dhe institucionet, profesionistët dhe komisionet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për përmbylljen me sukses të këtij procesi.

## Bahtiri me përfaqësues të KFOR-it flasin për hapjen e urës mbi lumin Ibër

MITROVICË, 10 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e Batalionit Rajonal të KFOR-it për veriun e Kosovës, nënkolonel Ervin Hartman, me të cilin ka biseduar për situatën e përgjithshme të sigurisë që po mbretëron në qytetin e Mitrovicës, me theks të veçantë për hapjen e urës mbi lumin Ibër.

Bahtiri ka falënderuar komandantin e KFOR-it për kontributin e tij dhe të ushtarëve të tij për Mitrovicën, ku tha se falë angazhimit të drejtuesve të komunës dhe mbështetjes të parezervë të KFOR-it dhe institucioneve të tjera vendore dhe ndërkombëtare, situata e sigurisë në Komunën e Mitrovicës është shumë më e mirë dhe ka shkuar drejt një stabilizimit të plotë.

Po ashtu, ai ka folur edhe për rëndësinë e hapjes së urës mbi lumin Ibër, ku theksoi se ajo duhet të bëhet në mënyrë madhështore e jo me tensione. "Ne kemi punuar gjatë së bashku me drejtuesit e komunës në veri të qytetit, që situata e sigurisë, lëvizja dhe qarkullimi i lirë i njerëzve dhe mallrave të përmirësohen. Falë kësaj pune, por edhe komunikimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes që kemi pasur nga komandanti i paqeruajtësve të KFOR-it për veriun e Kosovës, sot në tërë Mitrovicën kemi një situatë shumë më të relaksuar, e cila po shkon me hapa të sigurt drejt stabilizimit të plotë", ka thënë Bahtiri.

Komandanti i KFOR-it, nënkolonel Ervin Hartman, ka pohuar se ndihet mirë kur dëgjon për përparime për përmirësimin e situatës së sigurisë në këtë komunë.



## Zyrtarëve të BE-së u kërkohet të përgatiten edhe për Brexit pa marrëveshje



LONDËR, 10 TETOR - Zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian u paralajmëruan të mërkurën për mundësinë e daljes së Britanisë nga blloku pa marrëveshje. Procesi i njohur si Brexit duhet të përfundojë deri në mars të vitit të ardhshëm. Negociatori i BE-së për Brexitin, Michel Barnier, dhe sekretari i përgjithshëm i Komisionit Evropian, Martin Selmayr, i njoftuan komisionarët evropianë për përparimin e bërë në negociata vetëm një javë para samitit të 18 tetorit për Brexitin, i cili është cilësuar si "momenti i së vërtetës".
Barnier tha se negociatat në nivel teknik do të vazhdojnë edhe këtë javë.
Selmayr, i cili është ngarkuar me koordinimin e punëve për mbrojtjen e BE-së nga dëmtimi ekonomik dhe politik nëse Brexiti bëhet pa marrëveshje, tha se palët duhet të përgatiten "për çdo rezultat".
Brukseli dhe Londra kanë caktuar mesin e tetorit si afat për finalizimin e marrëveshjes mbi kushtet e daljes së Britanisë nga BE-ja. Por, të dyja palët mbeten të ndara, sidomos rreth çështjes së kufirit irlandez, indikacioneve gjeografike, të cilat specifikojnë origjinën e mallrave të caktuara bujqësore dhe rolit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.
Muajin e kaluar Fondi Monetar Ndërkombëtar ka paralajmëruar se ekonomia e Britanisë do të ketë rënie të menjëhershme nëse largohet nga BE-ja pa marrëveshje mbi kushtet e divorcit. Mbretëria e Bashkuar duhet të dalë nga BE-ja më 29 mars 2019, në përputhje me referendumin që ka mbajtur për këtë çështje në vitin 2016.

# Në Bosnjë e Hercegovinë vazhdon mizorja

**Shumica e politikanëve gjermanë janë të shqetësuar thellë me rezultatet e zgjidhjeve të fundit në Bosnjë e Hercegovinë dhe thonë se fitorja e nacionalistëve cenon bazat e shtetit**



© DW/D. Maksimovic

BERLIN, 10 TETOR - Politikanët gjermanë, në një intervistë për DW, shprehen të shqetësuar me rezultatet e zgjedhjeve në Bosnjë Hercegovinë. Në veçanti, thonë ata, fitorja e nacionalistëve cenon bazat e shtetit. Shumica e politikanëve gjermanë janë të shqetësuar thellë me rezultatet e zgjidhjeve të fundit në Bosnjë e Hercegovinë. Politikani i CDU-së, Michael Brandt, thotë se në Bosnjë e Hercegovinë mizerja po vazhdon, e kjo do të thotë se në këtë vend nuk vërehet ndonjë zhvillim në drejtim pozitiv. "Partitë nacionaliste vazhdojnë ta kenë fjalën kryesore dhe ato po e bllokojnë në mënyrë të paskrupullt funksionimin e shtetit. Dëshmia më e mirë për gjendjen në këtë vend është largimi masiv i të rinjve nga Bosnjë e Hercegovina", thotë Brandt në intervistë për "Deutsche Wellen".
Ndërsa deputeti socialdemokrat në Bundestag, Josip Juratoviq, mendon se "Bosnjë e Hercegovina patjetër ka nevojë për një Dejton të dytë, sepse vendi tani nuk është duke funksionuar". Juratoviq thotë se ky vend aktualisht është në një gjendje kaotike, ndaj duhet krijuar kushte për dalje nga kjo gjendje.
Në Presidencën treanëtarëshe të Bosnjë e Hercegovinës në mandatin e ardhshëm do të jetë presidenti i deritanishëm i Republikës Srpska, Milorad Dodik. Ai ka paralajmëruar se nuk do të shkojë fare në Sarajevë në mbledhjet e kryesisë, por atje do ta dërgojë përfaqësuesin e vet, apo do të kyçet me Skype.

### Dodiku, zjarrvënës

"Dodiku është një politikan që prej vitesh po përpiqet t'i vë flakën vendit ku jeton. Si mund ta përfaqësojë vendin një politikan i cili me të gjitha mjetet angazhohet kundër këtij shteti?", pyet Brandt.
As eksperti Bodo Weber nuk dyshon fare se "Dodiku do ta bëjë atë që ka paralajmëruar". Dodiku në 12-13 vjetët e fundit angazhohet për rrënimin e rendit kushtetues në Bosnjë e Hercegovinë. Sa iu përket raporteve të Dodikut me Beogradin dhe presidentin Aleksandar Vuçiq, eksperti gjerman thotë se "raporti i tyre dikur nuk ka qenë i mirë". Pyetja kryesore që shtrohet në këtë moment është se sa Dodiku varet nga Beogradi? "Natyrisht se politika e Republikës Srpska varet në një masë të caktuar nga Beogradi. Por Dodiku nuk do të vijë në Beograd për të marrë direktiva. Dodiku dhe Vuçiqi do të kenë një lloj aleance të përbashkët", mendon Weberi.

### Komshiqi më i matur

Përfaqësuesi i kroatëve në Presidencë, Zhelko Komshiq, për dallim prej Dodikut, angazhohet qartë për një shtet unik. Ndërsa përfaqësuesi boshnjak Shefik Xhaferoviq, sipas politikanit të CDU-së, duhet të dëshmojë se është i gatshëm të dalë nga hija e anëtarit të deritanishëm të Presidencës, Bakir Izetbegoviq.
Michale Brandt mendon se Bashkimi Evropian dhe Gjermania duhet ta ndryshojnë politikën e tyre ndaj Bosnjë dhe Hercegovinës. "Bosnjë e Hercegovina është e paralizuar me Marrëveshjen e Dejtonit. Asnjë vend tjetër në botë nuk ka tre presidentë. Asnjë vend nuk ka një Kushtetutë kaq të ndarë etnikisht dhe diskriminuese, si Bosnjë e Hercegovina. Kushtetuta e bazuar te Marrëveshja e Dejtonit ka dështuar. Dejtoni ka ndryshuar hartat etnike brenda vendit dhe ka ndarë vendin në baza etnike. Evropa dhe Gjermania duhet të tregojnë më shumë guxim për ta ndryshuar gjendjen", thotë Brandt.

## Kina me rregulla më të ashpra kundër grupeve etnike myslimane



PEKIN, 10 TETOR - Autoritetet kineze nisën një fushatë kundër prodhimeve hallall, për ta parandaluar Islamin që të depërtojë në jetën sekulare dhe ta ushqejë "ekstremizmin" në rajonin veriperëndimor Ksinjiang, ku grupet etnike myslimane përballen me kufizime fetare.
Hallall - nga arabishtja i lejueshëm - u referohet disa rregullave që i udhëzojnë myslimanët se çka është e lejueshme të përdoret si ushqim.
Pekini, vitet e fundit, është duke aplikuar masa të rrepta të sigurisë në Ksinjiang kundër, siç thotë, elementeve separatiste.
Sipas një raporti të mëhershëm të Kombeve të Bashkuara, rreth një milion myslimanë mbahen në kampe të riedukimit politik.
Udhëheqësi i Partisë Komuniste në Urumki, kryeqytetin e Ksinjiangut, kërkoi nga zyrtarët të thonë se nuk kanë fe, përveç ideologjisë marksiste, dhe të flasin vetëm gjuhën mandarine në publik. "Besimi im është marksizmi-leninizmi. Unë duhet ta valoj flamurin lart dhe ta luftoj tendencën Hallall, i vendosur në besimet e mia, madje deri në vdekje!", thotë betimi i ri.
Ujgurët dhe grupet e tjera etnike myslimane kryesisht në Ksinjiang janë subjekt i rregullave strikte që ndalojnë mjekrën dhe burkat dhe shumë prej tyre janë arrestuar në kampet e riedukimit për vepra të vogla, si kontaktimi me anëtarët e familjes jashtë vendit, është thënë në një raport të OKB-së në muajin gusht.

# DOLI NGA SHTYPI LIBRI I DHJETË I PROF. DR. IUR. EQREM ZENELAJ "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË VEPRAT E ARTISTËVE EVROPIANË"



E rrallë

## Policëve në aeroporte u kërkohet të qeshin më pak



Policëve në aeroportet e Indisë u është kërkuar të qeshin më pak. Ky vendim është marrë duke u justifikuar se atmosfera festive mund ta krijojë idenë e mungesës së sigurisë dhe është kërcënim për sulme terroriste. Forca Industriale e Sigurisë së këtij shteti, e cila është përgjegjëse për sigurinë e fluturimeve, ka kërkuar nga stafi të jetë "më vigjilent sesa i shoqërueshëm".

FOTO E DITES



Vullkani de Fuego i Guatemalës ose vullkani i zjarrit është një nga vullkanet më aktive në botë. / Nacional Geographic/

E jashtëzakonshme

## E lodhur me pyetjen se kur do të martohet, studentja 32 vjeçe martohet me veten



Një vajzë beqare e lodhur nga pyetja e shpeshtë se kur do të martohet, ka bërë që ajo të ndërmarrë një veprim të pazakontë, të martohet me veten. Studentja e Oksfordit, Lulu Jemimah, 32 vjeçe, ishte ngopur nga "fjalimet" që ia mbanin familjarët lidhur me rëndësinë e martesës dhe gjetjes së mashkullit të ëndrrave.

## BARSOLETA E DITËS



**Goni: Dost, a dëgjove se është shtrenjtuar benzina?**
**Loni: As që po mërzitem, se ashtu-kështu çdoherë ia qes 5 euro!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

### "ALPHA" 3D,



Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**

**Në ora 16:00**

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"



Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

**Në ora 18:00**

### "NIGHT SCHOOL"



Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee

**Në ora 20:00**

### "SIBERIA",



Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

**Në ora 22:00**

### "VENOM" 3D,



Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nëse jeni të irrituar nga sjellja e disa personave të caktuar, sot nuk është dita e duhur për t'u vënë në dukje.



**DEMI**
Në këto çaste nuk keni nevojë për publicitet negativ në ambientin që ju rrethon. Mos reagoni hapur për gjëra që nuk i pranoni.



**BINJAKËT**
Megjithëse e keni ngritur më shumë sesa që duhet pritshmërinë e eprorëve tuaj, sot mund ta rikuperoni përpara se t'ju kritikojnë.



**GAFORRJA**
Sjellja juaj sot do të jetë në varësi të një situate të caktuar. Bëni mirë të jeni më i pranishëm në familje që të përjetoni çdo çast interesant.



**LUANI**
Po bëheni shumë tendencioz karshi atyre personave që duan t'ju ndihmojnë sot. Edhe pse mund të keni rezerva bashkëpunimi është rruga më e mirë.



**VIRGJËRESHA**
Sot nuk keni shumë kohë në dispozicion t'i ndryshoni idetë tuaja. Edhe pse nuk kanë ecur në fillim do të mund t'i rregulloni gjërat rrugës.



**PESHORJA**
Mbase ngaqë nuk keni qenë shumë të vëmendshëm gjërat ju kanë ikur nga kontrolli. Do t'ju duhet pak kohë përpara se të riorganizoheni.



**AKREPI**
Dita e sotme do të evidentojë një person që meriton ta ketë vëmendjen tuaj dhe t'i jepni shanset e duhura në jetë.



**SHIGJETARI**
Mbase keni dhënë përshtypjen e gabuar ose jeni përplasur me një njeri që nuk kishte fare interesa të konfliktohej me ju, por sot do të rimendoheni.



**BRICJAPI**
Sot ndiheni pak nervoz dhe këtë gjë po mundoheni ta kamufloni. Një person i caktuar do ta kalojë cakun në debat me ju.



**UJORI**
Humori dhe ndjeshmëria juaj sot do t'ju ndihmojnë të përballoni edhe situata mjaft stresante që në ditë të tjera do t'ju kishin nervozuar.



**PESHQIT**
Ju vetë e dini që keni munguar në një ngjarje vërtet të rëndësishme të një personi të afërt. Do të mundoheni që të kërkoni falje.

# Kylie Jenner e do edhe një fëmijë të dytë



Kylie Jenner është gati edhe për një fëmijë të dytë. Jenneri ka deklaruar se do të ketë edhe një fëmijë tjetër, por tani nuk është koha e duhur. "Dua edhe një fëmijë tjetër por, definitivisht, tani nuk jam gati për një fëmijë të dytë", është shprehur ajo. Më tej, raportohet se Kylie Jenner dëshiron që edhe fëmija i dytë i saj të jetë vajzë pasi ajo tashmë është duke menduar edhe për emrin. "Dua që ajo të ketë me të vërtetë një emër feminist", ka thënë ajo.

# Emily Ratajkowski, e mrekullueshme rrugëve të Nju Jorkut


© TheImageDirect.com

Në çdo rast ajo e tregon se ka një trup dhe pamje modelueseje. Emily Ratajkowski u fotografua në Nju Jork, veshur me një xhaketë me lule dhe pa reçipeta. 27-vjeçarja dukej e mrekullueshme me këtë veshje. Modeluesja e kishte kombinuar xhaketën-fustan me një palë atlete.


© Getty Images for DCP

# Dua Lipa ndez skenën e AMA-s

Pavarësisht prej nominimeve në American Music Award, Dua Lipa nuk arriti të merrte një çmim. Mirëpo kjo nuk e ka penguar këngëtaren shqiptare që ta ndezë skenën e AMA-s. Gjatë ndarjes së çmimeve në skenë doli Dua Lipa që elektrizoi sallën me këngët "One Kiss" dhe "Electricity". 23-vjeçarja ishte veshur me reçipeta dhe pantallona të bardha të gjata.

# Autografi i veçantë i Messit



Një fans i ka bërë një kërkesë të veçantë idhullit të tij, Lionel Messit. Ai i është lutur që autografin t'ia lërë në shpinë, mbi një tatuazh gjigant që kishte si subjekt pikërisht "Pleshtin". Messi, edhe pse paksa i çuditur, ia ka plotësuar dëshirën, por pyetja që bëhet në këtë rast është: Sa do të rezistojë ky djalosh pa bërë dush?

# Kryearkitekt Kasëm Grëmshi i Tomoricës, në dokumentet osmane



Është shumë e vështirë të shkruash për njerëz të shquar me veprën që kanë lënë, kur dokumentet e tyre, janë të shpërndara nëpër arkiva botërore. Një ndër këta njerëz gjigantesk, për të cilin ka shumë dokumente të shpërndara është dhe arkitekti i madh i Shqipërisë, Kasëm Grëmshi nga Tomorrica e Skraparit. Ai është një ndër figurat e mëdha historike arkitekturore të Shqipërisë në Perandorinë Osmane, me përmasa botërore .

Nga studimet që kam bërë deri tani nëpër arkiva a biblioteka shkencore në Turqi, ( 24.03.2004 – 2018 ) Kasëmi rreshtohet si arkitekt dhe kryearkitekt, midis shumë të tjerëve arkitekt e kryearkitekt në këtë Perandori, duke filluar nga fundi i shekullit XVI dhe vazhdimi në shekullin XVII. Në të njëjtën kohë, ky njeri i madh me veprën që bëri gjatë jetës së tij, si arkitekt e kryearkitekt, ka qenë dhe një figurë e madhe politike në kohën e sulltan Muratit IV ( 1623 – 1640 ) dhe sulltan Ibrahimit ( 1640- 1648 ).

Kam 21 vjet që kërkoj foton e tij nëpër arkiva e biblioteka shkencore



në Turqi, por atë nuk e gjeta në këto vite. Për fat të mirë, më 24.04.2018, nga kontrolli që bëra me shokun e bibliotekës (dhe ai me origjinë shqiptare ), së vjetër shkencore, përballë Universitetit të Stambollit në Bajazit, e gjeta foton e tij. Kjo datë e madhërishme, por dhe interesante përkoi me gjetjen e disa shkrimeve, më 24.03.2004, (muaji ndryshon) në bibliotekën e madhe shkencore, "Islam Ansiklopedi" në Ballarbashë, në pjesën e sipërme, në Yskydar. Kështu, mbas 358 – 359 viteve, sipas datëlindjes së ti , kjo foto u gjet nga kërkimet e historianëve turq.

Kasëmi u lind në fshatin Grëmsh të Tomoricës së Skraparit. Data e lindjes dhe ajo e vdekjes nëpërmjet shkrimeve arkivore në Turqi nuk gjendet e saktë. Nga studimi i shumë dokumenteve arkivore, nëpër biblioteka shkencore a në Arkivin Osman, në Turqi , gjen dokumente me datëlindje të ndryshme. Në këto libra enciklopedikë, shkruhen këto data: 1567,978/1570 ( sipas kalendarit të vjetër Hixhri i takon viti 978 dhe sipas kalendarit të ri, Miladin i takon viti 1570 ). E njëjta gjë,ndodh dhe me datën e vdekjes.

Sipas dokumenteve të kohës datat :1659 ose 1070/1660 tregojnë kohën e vdekjes në Stamboll. Sidoqoftë , kryearkitekti i Perandorisë Osmane, Kasëm Agai ose Koxha Kasëm Agai nga Grëmshi ose Gramesh – Garmish , (të shkruara sipas dokumenteve ), ka jetuar midis moshës: 89 – 90 -92 vjeç. Varri i tij është vendosur në varrezat e mëdha me emrin "Karaxhaahmet ", në Yskydar , Stamboll , si një përmendore e madhe e mermert, në të cilën janë shkruar të dhëna të jetës së tij në gjuhën osmanisht .

Kasëmi , ishte djali i Aliut. Emri i nënës së tij ende nuk është gjetur në këto dokumente. Ai, sipas dokumenteve ka qenë djalë i shëndetshëm i marrë nga turqit, fëmijë dhe është dërguar në sarajet e sulltanit . Koha e marrjes nga Grëmshi dhe e dërgimit në Turqi i përket kohës së sundimit të sulltanit të XI , Selimit të dytë (1566 – 1574 dhe sulltanit të XII , Muratit të tretë (1574 – 1595 ) Është koha e rrebesheve osmane, të viteve, 1570, 1699, 1701, 1714 -1715, 1717, 1828, 1842 etj , kur taboret turko-osmane vërshuan në Shqipëri dhe po ashtu në fshatin e Grëmshit që atë kohë kishte 400 e ca shtëpi. Vërshuan atje, se nga Grëmshi dolën figura të shquara, si: Mehmet Allko , Mustafa Osmani, Muço Beqiri e të tjerë, të cilët u ngritën me zotësi e zgjuarsi, si udhëheqës, duke e tërbuar ushtrinë turke . Pikërisht dhe në vitin 1570, kur ka lindur Kasëmi, kanë ardhur turqit-osmanë. Kasëmi , ky fëmijë i vogël (mosha nuk është shkruar në këto dokumente, por shkruhet acemi-axhemi, pra fëmijë ), u çua dhe u rrit në sarajet e sulltan të XI, Selimit të dytë dhe sulltanit të XII, Muratit të tretë.

Aty u rrit e mori mësimet për arkitekt. Në periudhën e sulltan Mehmetit III (1595 -1603 ), Kasëmi i Grëmshit , punoi si arkitekt në sarajet e këtij sulltani. Nga puna e tij e madhe, më pas, në moshën 52 vjeç , arriti një shkallë të lartë të veprimtarisë arkitekturore dhe si rezultat i kësaj pune, autoritetet qeveritare osmane, e dërgojnë në Hasbahçe.

Mjeshtërinë arkitekturore e mësoi nga Davud Aga. Emri i tij si arkitekt për herë të parë është dëgjuar në vitin 1597, në moshën 27 vjeç, gjatë riparimit të Hamamit të Valide Sulltanit, që ndodhej në lagjen Dikilitash . Mbas vdekjes së kryearkitektit, Hasan Agës- agait,më 1622, Kasëm Aga Koxhajin (Kasëm beun e madh) , e dërgojnë me detyrë në kryesinë e arkitekturës, si kryearkitekt në moshën 52 vjeç.

Për jetën e tij, kanë shkruar shumë studiues, si: Mehmet Syreja, "Sicill-i Istanbul 1308. IV. 49 .,një biografi e shkurtër, Ahmet Refik ( Altënaj) dhe F.Babinger në vitin 1924 , shkruajnë biografinë e parë, më të saktë se Mehmet Syreja. Këtë biografi e botuan: E. Kuhner"in,,më 1927 , bëri botime me shumë gabime . Për herë të parë është shkruar një artikull për varrin e Kasëmit nga A.Kemaleddin në vitin 1934 . Ka shkruar, Izet Kumbaraxhëllar e të tjerë studiues.

Më mbrapa, detyrën si kryearkitekt, e vazhdoi në Sarajin historik të Topkapës (Dera e Topit), në ndërtimin e Qoshkut Sepetçiler xhami. Autoritetet osmane, duke parë se shkalla e artit të Kasëmit ishte e madhe, e lejuan të ndërtonte Jeni Xhaminë ose Xhaminë e Re, të projektuar nga arkitekti Davut Aga, në vitin 1598. Për ndërtimin e saj morën pjesë dhe katër arkitektë të tjerë.

Në disa dokumente, shkruhen të dhëna të shkurtra për jetën e tij, duke filluar nga 5 rreshta, deri në 50 rreshta. Këto shkrime janë të shpërndara pa një radhitje kronologjike historike dhe shpeshherë, shkruhen të njëjtat gjëra. Me hulumtimet e mia që ende vazhdojnë po sistemohet vepra e tij. Në kohën e Perandorisë Osmane, të shekullit XVI – XVII ka pasur shumë arkitektë dhe kryearkitekt të mirë, për të cilët nuk ka njohuri të mjaftueshme për veprën e tyre. Shkrimet apo dokumentet që kanë arritur deri më sot janë të pakta, të ngatërruara, sidomos para 20 viteve.

Gjatë historisë së Perandorisë Osmane, humbën shumë dokumente për arkitektët, ku radhiten dhe humbjet e shkrimeve të Kasëmit të Aliut. Emri i vërtetë në shumë dokumentet osmane është shkruar: "Kasëm Aga" , por për shkak se ai ishte një arkitekt shumë i madh, mbas arkitekt Sinanit, atë e kanë thirrur dhe "Koxha-Arkitekt, që do të thotë : "Arkitekt i madh".

Kasëm Again, e nderua sulltanët, ministrat dhe kryeministrat e Perandorisë Osmane. Vetë ai arriti të fitojë shoqëri të madhe dhe autoritet me sulltan Ibrahimin e Parë dhe me kryeministrin Kara Mustafa Pashën . Nëpër dokumentet enciklopedike turke, emrin e Kasëmit, e gjen të shkruar në këtë mënyrë : 1.Koca mimar Kasëm Aga. (Koxha arkitekt Kasëm Aga .2. Kasëm Agha. 3. Koca Kasëm Aga.4.Kasëm Aga. 5.Kasëm Aga Koxha.( Kasim Aga Koca), Reis Koxha, me kuptimin, njeri i ditur, jo vetëm në arkitekturë .

Dikush shkruan pak, dikush më shumë, dikush ka gabuar, duke e ngatërruar veprën e Kasëmit , me veprën e arkitekt Sinanit, i cili e ka pasur Kasëmin nxënës të shkëlqyer. Mbas vdekjes së arkitekt Sinanit, më i dëgjuari arkitekt ka qenë Kasëmi shqiptari. Veprimtaria e madhe, e shkëlqyer arkitekturore e Kasëmit fillon nga viti 1622 dhe mbaron në vitin 1651, gati 8 vjet para vdekjes së tij, nëse ka vdekur në vitin 1659 ose 9 vjet para vdekjes, nëse ka ndërruar jetë, në vitin 1660. Pra, dhe i moshuar dhe i sëmurë ai e ka vazhduar punën. Në dokumentet osmane të kryeministrisë, në Ankara,të cilat do të paraqiten në librin kushtuar Kasëmit, ka vendime të qarta, ku Kasëm Grëmshi, emërohet si kryearkitekt i Perandorisë. Nga studimet, Kasëmin e emërojnë 7 herë si kryearkitekt.



Kështu, gati 30 vjet arkitekt e kryearkitekt, Kasëm Aga Grëmshi punoi në Perandorinë Osmane, duke lënë një veprimtari të madhe arkitekturore, duke filluar që nga punimet arkitekturore në fshatin e tij, në Grëmsh, në Çorovodë, (Ura e Kasabashit "ose ura e kokës ose mendjes së Kasëmit), në Berat, në Greqi, ku ka projektuar shumë ura, në Gjermani etj. Prodhimtaria më e madhe arkitekturore, është në Turqi.

Për veprat e tij përmendim midis të tjerave në fshatin e tij: xhami, imamet, hamam, han, dy çezma .Në Elbasan, në vendin e quajtur: CURE , ku është i pasaktë, sipas shkrimit ka bërë, një han, në Shpat dhe në Rabrova ka pasur toka – prona dhe mulli me ujë. Në Berat: Një hamam, 7 çezma, xhami,në fshatin Dushnik : prona dhe kopshte me ullinj, vakëfe, etj. Në Avlonja (Vlora ) Sanxhak në fshatin Kozarë, ka pasur 7 prona ….

Në Turqi : Konja Sherefedin Xhami, Sarajet e Topkapës: Revan Qoshku, 1636 , Bagdat Qoshku, 1639, Sepetiler Qoshku , 1643, në Yskydar: Çinli xhami, Medreseja në Shehzadebashë dhe shumë vepra të tjera arkitekturore, të cilat po studiohen nga për një libër të veçantë.

Në këtë shkrim simboliko-historik, hodha pak rreze drite, për një figurë të madhe arkitekturore shqiptare, nga Grëmshi i Tomoricës, me përmasa botërore, me dokumente arkivore, të arkivave e bibliotekave shkencore në Turqi dhe jo me gojëdhëna, siç janë shkruar më parë. Kam shpresë se me hulumtimet e mia në vazhdim, do të dalë më e plotë figura e këtij gjeniu të arkitekturës shqiptare, që ndodhet nëpër arkivat botërore.

Kasëm Grëmshi ose Koxha Kasëm Agai ,është një Gjeni i arkitekturës botërore.

*(Asqeri Diko/ gazeta-Shqip.com)*

# Turqi-Siri, jeta përgjatë murit që ndan dy botë




Jeta e 3,5 milionë refugjatëve sirianë në Turqi has në vështirësi të shumta, por ata gëzojnë që janë të sigurtë. Ndërkohë të afërm të tyre ende përballen me luftën në anën tjetër të kufirit turko-sirian të izoluar prej tre vjetësh nga një mur 800 km. i gjatë dhe i vrojtuar mirë.

Rreth 800 km është muri prej betoni, që ka ndërtuar Turqia para tre vjetësh përgjatë kufirit me Sirinë, për të ndaluar "terroristët dhe kontradandistët", sikurse thuhet. Refugjatë të rinj nuk lejohen më të hyjnë në vend. Ndaj shumë familje siriane jetojnë të ndarë, përgjatë murit. Ata nuk kanë më shpresë se së shpejti mund të bashkohen dhe se do të mund t'i shpëtojnë të afërmit e tyre prej luftës në Siri.

Më shumë se 3,5 milionë refugjatë jetojnë ndërkohë në Turqi. Në anën siriane të kufirit njerëzit vazhdojnë të jetojnë me frikë. Provinca veriore e Sirisë Idlib konsiderohet si fortifikata e fundit e rebelëve – më shumë se tre milionë njerëz jetojnë ndërkohë atje, gjysma janë të dëbuar nga vende të tjera të Sirisë.

## Ndarja e familjeve

Shumë refugjatë kanë ende të afërmit e tyre në anën tjetër të kufriit, ku vazhdon të gjëmojë lufta. Njëri prej tyre është Abdulmajid, që e sheh të motrën Fatima vetëm në videot nga celulari. Të shumtën e herëve ajo nuk ka lajme të mira. Tek i thotë, se sërish kanë rënë predha në shtëpinë e tyre, por falë Zotit ata kanë shpëtuar nga më e keqja. Fatima është në një fshat pranë Idlibit – Abdulmajid është në qytezën Reyhanli, në Turqi. Para gjashtë vjetësh ai u arratis dhe shkoi në Turqi, ndërsa e motra mbeti në Idlib, rrëfen Abdulmajid Al Halabi: "Shtëpia e saj u shkatërrua gjatë një sulmi dhe ajo bashkë me fëmijët u arratis në fshatin e prindërve tanë. Por më vonë edhe atje nisën bombardimet. Fatima as që nuk e besonte se lufta do të zgjasë kaq shumë."

Me shumë refugjatë të tjerë Abdulmajid na tregon, se si jeton në Turqi: Në një kamp gjysmë-ilegal me çadra, në një mjedis të ngushtë bashkë me gruan Dohok dhe me pesë fëmijët. "Ne jetojmë këtu, sepse kjo është mundësia jonë e vetme. Por duhet ta shihni një herë se si është këtu në dimër. Toka është plot baltë jashtë dhe është shumë ftohtë. Eshtë vërtetë një jetë e vështirë.

Sado të vështira që janë rrethanat, familja Abdulmajids është këtu të paktën në siguri. Para tre vjetësh Turqia i mbylli kufijtë me Sirinë dhe filloi të ndërtojë një mur: tre metra të lartë dhe të mbikqyrur rreptësisht. Muri është 800 km i gjatë – dhe do të zgjatet edhe më shumë. Pasojat e këtij vendimi janë të prekshme: Majtas ana turke e kufirit pa këmbë njeriu – djathtas ana siriane mbushur me kampe të dëbuarish aq sa të kap syri në horizont. Organizatat e ndihmës kujdesen për njerëzit atje. Ndihmësit e Gjysmë Hënës së Kuqe turke dërgojnë rregullisht furnizime për në Idlib.

## Ndikimi i ardhjes së refugjatëve në jetën e turqve

Të paktën katër deri në pesë herë në javë e bëjnë ata turin e furnizimeve drejt anës tjetër të kufirit. Në qytetin kufitar turk Reyhanli njerëzit janë krenarë, që vendi i tyre prej vitesh jep kaq shumë ndihma. Asnjë vend tjetër në botë nuk ka pranuar kaq shumë refugjatë. Por ka edhe shumë që thonë tani mjaft më. Kriza monetare ka shtrenjtuar gjithçka, njerëzit kanë problemet e veta.

-"Ne kemi pranuar kaq shumë sirianë. Më shumë nuk bëhet më, ne nuk e duam këtë."

-"Edhe sikur të na duhej të arratiseshim ne do ta bënim këtë. Unë mendoj se ata duhet të vijnë."

-„Ata po na marrin vendet e punës. Dikur ne fitonim 80 Lira në ditë. Tani sirianët po i bëjnë punët tona për gjysmën e rrogës sonë." Abdulmajid dhe familja e tij natyrisht që e ndjejnë skepticizmin dhe refuzimin kundrejt tyre. Megjithatë ata janë mirënjohës. Presidentin turk këtu në çadrat e kampit e konsiderojnë si hero – aq më tepër pasi ai ia doli që të parandalojë tani për tani ofensivën ushtarake në Idlib.

Presidenti turk Erdogan dhe ai i Rusisë Putin së fundi ranë dakord për një zonë të çmilitarizuar për Idlibin, një ofensivë në shkallë të gjerë siriano-ruse mundi kësisoj të parandalohet, e po ashtu edhe katastrofa e mundshme humanitare dhe një valë e re refugjatësh drejt Turqisë. Të gjithë xhihadistët duhet të tërhiqen dhe të dorëzojën armët, por është e paqartë, nëse kjo vërtetë do të funksionojë. *(gazeta-Shqip.com)*








# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | KOSOVO - MALTA | X-1 | POLAND - PORTUGAL | 3+ | WALES - SPAIN | 3+ |

# 'Dardanët' për fitore ndaj Maltës

**Kosova sonte kërkon maksimumin nga ndeshja ndaj Maltës në kuadër të Ligës së Kombeve. Futbollistët janë përgatitur maksimalisht dhe të motivuar për këtë ndeshje, kurse trajneri Bernard Challandes ka premtuar lojë të mirë. Zvicerani ka konfirmuar se e respekton Maltën, por që nuk ia ka aspak frikën**



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll kërkon fitoren e dytë në Ligën e Kombeve. Tre pikët e reja "Dardanët" i duan edhe nga përballja me Maltën, e cila vlerësohet si një kundërshtar mjaftë i fortë. Kapiteni i Kosovës, Samir Ujkani në konferencë për medie, ka thënë se Malta ka ardhur me synim për të marr pikë, prandaj skuadra përfaqësuese e Kosovës duhet të jetë e kujdesshme gjatë gjithë ndeshjes. Numri një i portës se Kosovës pret një rezultat të mirë nga kjo përballje qw zhvillohet nw stadiumin "Fadil Vokrri". "Malta vjen këtu me marrë pikë sikurse ndaj Azerbajxhanit, por ne duhet të kemi kujdes. Ne jemi përgatitur mirë për të marrë një rezultat të mirë, por jemi të vetishëm se e kemi përballë një ekip të fortë me lojtarë që kanë përvojë", ka thënë Ujkani, i cili më pas e ka kritikuar mënyrën e shitjes se biletave. "Interesimi gjithmonë ka qenë i madh, edhe kur nuk kemi qenë të pranuar në UEFA dhe FIFA, por nuk jam i kënaqur më mënyrën se si janë shitur biletat, pasi populli nuk e meriton një gjë të tillë. Edhe lojtarët kanë mbetur pa bileta dhe duhet të gjendet një formë tjetër për shkuar shitja në rregull", ka thënë Ujkani. Në konferencë për medie i pranishëm ishte edhe trajneri Bernard Challandes, i cili nuk thotë se Kosova është favorite ndaj Maltës, por konfirmon se nuk ia ka frikën kundërshtarit. "Ne si trajnerë gjithmonë e themi të kundërtën, pra për kundërshtarin se është favorit. Kam respekt për ekipet tjera, por jo frikë. Filozofia ime gjithmonë është të japim përformacen më të mirë të ekipit dhe jo të shënojmë pesë apo gjashtë gola. Kam besim të plotë në të gjithë skuadrën dhe pres nga lojtarët të japim maksimumin, kurse pres përkrahje të madhe nga shikuesit", ka thënë Challandes. "E kam studiuar lojën e Maltës ndaj Azerbajxhanit, dhe mund të them se ka qenë skuadër më e mirë. Kanë ekip kompakt në gjysmëfushën e mbrojtjes, kurse janë të rrezikshëm në kundërsulme. Kërkojë nga lojtarët të luajmë lojë të mençur dhe mos të shkojmë vetëm në sulem. Ideja është të krijojmë hapësira për pasime dhe t'i afrohem golit", ka deklaruar ai. Trajneri zvicerean ka refuzuar të tregoi përbërjen bazë të ekipit me arsyen se këtë do të bëjë të enjten në mëngjes me futbollistët. Ndërsa në lidhje me ndeshjen kundër Maltës, Valon Berisha, ka deklaruar: "Në radhë të parë jam i lumtur që pas një lëndimi jam kthyer në Kombëtare gati u bënë një vit. Jemi duke u përgatitur mjaft mirë dhe unë besojë se do të shënojmë fitore, por as sesi nuk mendojë se do ta kemi të lehtë, Kemi një atmosferë të mirë dhe po punohet me përkushtim".

Të mërkurën në konference për medie ka dal edhe trajneri i Kombëtare së Maltës, Ray Farrugia, i cili e ka vlerësuar lartë Kosovën, por njëkohësisht ka bërë të ditur se në Prishtinë kanë ardhur për fitore. "Sikur Kosova ashtu edhe ne kemi prurje të reja dhe jemi përmirësuar dukshëm. Kam thënë se Kosova është favorite duke u bazuar në futbollistët e saj që luajnë nëpër klube të mëdha dhe besojë se brenda pesë viteve Kosova do ta ketë një topskuadër", ka thënë Farrugia. Ndeshja në mes Kosovës dhe Maltës zhvillohet sonte në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45.

# TEB-i mbështet basketbollin dhe futbollin

**Dy federatat e Kosovës, Federata e Basketbollit dhe ajo Federata e Futbollit, kanë nënshkruar të mërkurën, me TEB bankën, marrëveshje për sponsorizim. "Për bankën TEB është nder dhe kënaqësi ta përkrahim Federatën e Futbollit të Kosovës dhe Federatën e Basketbollit të Kosovës materialisht duke sponsorizuar përfaqësueset e Kosovës, por ajo çka është më e rëndësishme është se si futbolli, ashtu edhe basketbolli kanë nevojë për përkrahjen e shikuesve në numër sa më të madh, sepse me të vërtetë e meritojnë një përkrahje të tillë", ka thënë Orcun Ozdemir, drejtor i Bankës TEB**




PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) edhe në të ardhmen do ta ketë mbështetjen e TEB bankës. Kontrata e sponsorizimit në mes TEB-it dhe FBK-së është nënshkruar të mërkurën në një ceremoni solemne. "Për bankën TEB është nder dhe kënaqësi ta përkrahim Federatën e Futbollit të Kosovës dhe Federatën e Basketbollit të Kosovës materialisht duke sponsorizuar përfaqësueset e Kosovës, por ajo çka është më e rëndësishme është se si futbolli, ashtu edhe basketbolli kanë nevojë për përkrahjen e shikuesve në numër sa më të madh, sepse me të vërtetë e meritojnë një përkrahje të tillë. Ne edhe në të kaluarën i kemi mbështetur të dyja federatat, më saktësisht përfaqësueset e Kosovës në futboll dhe në basketboll. Do të vazhdojmë sërish, duke marrë parasysh interesimin e madhe të të gjithëve për këto dy sporte. Unë uroj që përfaqësueset e Kosovës në futboll dhe basketboll të arrijnë të shënojnë rezultate sa më të mira", ka thënë Orcun Ozdemir, drejtor i Përgjithshëm i TEB bankës.

Ndërsa kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, e falënderoi TEB-in për mbështetjen që po i jep basketbollit të Kosovës. "FBK-ja i është mirënjohëse bankës TEB për mbështetjen e vazhdueshme në forma të ndryshme për disa vjet radhazi. Ne e kemi filluar bashkëpunimin me TEB-in kohë më parë nëpërmjet sponsorizimit të ligave të kategorive të reja, ndërsa më pas e kemi vazhduar me përfaqësueset e reja të Kosovës, edhe tani në tre vjetët e fundit me Përfaqësuesen A të Kosovës. Ne jemi shumë të lumtur që e kemi një partner kaq të fortë si banka TEB, e cila na është gjendur gjithmonë pranë në forma të ndryshme, pra jo vetëm në ato materiale, por ka pasur raste kur drejtori Orcun Ozdemir ka udhëtuar me Përfaqësuesen e Kosovës vetëm për ta mbështetur dhe kjo për ne do të thotë shumë. Do të bëjmë përpjekje maksimale që të shënojmë rezultate sa më të mira dhe kështu do t'i bëjmë të gjithë krenarë", ka thënë Fetahu.

I pranishëm në nënshkrimin e marrëveshjes ishte edhe kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, i cili deklaroi: "Sigurisht se për ne, pra për Përfaqësuesen e Kosovës, është motivim kur e kemi përkrahjen financiare të bankës TEB. Unë dhe bashkëlojtarët do të përpiqemi sa më shumë të luajmë sa më mirë dhe kështu të arrijmë rezultate pozitive në parakualifikimet për 'Eurobasket 2021'".

Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futboll të Kosovës (FFK), Eroll Salihu, e falënderoi TEB bankën për mbështetjen e vazhdueshme. "TEB banka është treguar partnere e shkëlqyeshme dhe strategjike për neve dhe ndihem jashtëzakonisht i lumtur që bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka deklaruar Salihu. Ndërsa kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Samir Ujkani, ka deklaruar: "Është kënaqësi dhe nder për neve ta kemi sponsore një bankë kaq me renome si TEB banka".

## U19-shat ndahen baras me Austrinë

Prishtinë, 10 tetor - Në ndeshjen e parë të ndeshjeve parakualifikuese për Kampionatin Evropian, Përfaqësuesja e Kosovës U-19 ka mbetur baras, pa shënuar gola, në ballafaqim me Kombëtaren e Austrisë. Ishte kjo një ndeshje e fortë, por gjithsesi futbollistët e Kosovës ishin më të mirë se një vit më parë kur Austria shënoi fitore minimale prej 1-0, ndërsa kësaj radhe nuk arritën më shumë se një barazim. Ky barazim nuk është rezultat i keq duke marrë parasysh se Kosova i ka edhe dy ndeshje, ku më 13 tetor takohet me nikoqiren, Hungarinë, dhe më 16 tetor me Slloveninë.



## Mosmarrëveshjet mes Kovaqit dhe Bayernit kishin filluar gjatë verës

